



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 nr.350/02-147747/25 dt. 26.09.2025, (sipas e-Leja, KKN-00611) aplikuesve/pronarëve Ismajl Hyseni, Idriz Selmani, Etnik Hajdini dhe Arbër Hajdini nga Prishtina me investitorë “ALB Petrol” sh.p.k. nga Podujeva, me certifikatë të biznesit ARBK 812050657, dhe me pronar Idriz Ejupi nga Podujeva, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kriteret të caktuara për ndërtimin e kompleksit ndërtësive shumë banesore dhe afariste -“Ndërtesa 1 me etazhitet 2B+S+P+11”, si fazë e parë, në kuadër të parcelës ndërtimore “F-5”, të bllokut urban “F”, të tërësisë urbane “F”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, në Prishtinë në parcelat kadastrale, nr. 355-5, 355-6, 355-7 & 355-8 ZK Çagllavicë. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 28.10.2025 deri më 11.11.2025, në E-mail adresën: urbanizmpriштine@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Objekt Afaristo-Banesor “Ndërtesa 1 me etazhitet 2B+S+P+11”,
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~8.00 m’/7.50m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	~ 12.m’/ 7.00 m’(anësore) ~ 16.m’/ 7.00 m’(anësore) ~ 7.00 m’ / – 7.00 m’(e pasme)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40% e lejuar sipas planit rregullues ~ 40.00% e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISPN= 2.5 e lejuar sipas planit rregullues
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% e lejuar sipas Vendimit
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60% e lejuar sipas planit rregullues 60% e propozuar
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	54
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

